

“Mjedisi Sot”
Nr 2203 E Enjte 27/09/2007

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III
Kutia postare 127, Tirane
Tel/Faks (+355 4) 23 29 28
Email: info@albania.rec.org
Web: <http://albania.rec.org>
www.mjedisisot.info

PERMBAJTJA

NGA VENDI

- Seminar per prezantimin e planit strategjik te veprimit te kapaciteteve per menaxhimin e integruar te mjedisit
- Pub-et e zhurmshme do te mbyllen nga bashkia
- Shkoder, rinis djegia e plehrave te “varrezat e deshmoreve”
- Berat, zjarri shkumbon kodren me ullinj
- Drejtoria e rrugeve, masa permbytjet nga lumi drino

NGA BOTA

- Uashington, samit nderkombetar per ndryshimet e klimes
- Objektivat e gjermanise per dioksidin e karbonit “kushtojne shume”
- Bashkimi evropian autorizon misrin e modifikuar gjenetikiisht

Njoftime

- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivite per mjedisin, jane te mirepritura te

dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' info@albania.REC.org, ose Kutia Postare 127, Tirane.

Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.

Nga VENDI

seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC Shqiperi

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise dhe UNDP Shqiperi organizoi sot seminarin permbylles "Shqiperia – Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit" (NCSA) ne Hotel "Tirana International".

Plani Strategjik i Veprimit eshte mbeshtetur ne fushat e perbashketa te tre Konventave te Rios, permes vleresimit dhe analizes se nevojave prioritare te vendit per zbatimin e Konventave Globale Mjedisore dhe pasqyron ne terma praktike aktivitetet qe duhet te ndermerren per krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe te strukturave mbeshtetese me qellim menaxhimin e koordinuar e strategjik te mjedisit ne Shqiperi. Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve do te krijojte nje mjedis lehtesues per ruajtjen e biodiversiteti unik te vendit, do te lehtesoje zbutjen e vulnerabilitetit nen kushtet e ndryshimeve klimatike si dhe do te ndihmoje ne koordinimin e masave qe duhen marre per te luftuar shkretetirizimin dhe degradimin e tokes, duke ndihmuar ne te njejten kohe zbatimin e parimeve te zhvillimit te qendrueshem.

Pjesemarresit ne takim ishin perfaqesues te Ministrive te linjes, institucioneve kerkimore dhe arsimore, eksperte kombetare, OJF, si dhe perfaqesues te institucioneve financuese.

Per me shume informacion mbi Planin Strategjik, mund te kontaktoni:

Klodi Marika

NCSA/SLM

Manager

klodi.marika@undp.org

Pub-et e zhurmshme do te mbyllen nga Bashkia

Ermelinda Hoxhaj, Gazeta Shqiptare, fq. 13

Zhurmat e medha te shkaktuara nga klubet dhe lokalet e nates kane bere qe Bashkia e Tiranes te nise nje fushate per penalizimin e lokaleve qe abuzojne ne lidhje me kete gje. Sipas drejtorit te kabinetit ne Bashkine e Tiranes, Eduart Shalsi, "lokalet e nates qe nuk do respektojne normat dhe shkaktrojne shqetesime te banoret, do te ndeshkohen me gjoba deri ne 100 mije leke te reja si dhe deri ne mbyllje aktiviteti". Nisja e kesaj fushate nga ana e bashkise ka nisur nga takimet qe kryebashkiaku Rama po zhvillon me qytetaret e Tiranes ne cdo njesi bashkiake, ne lidhje me shqetesimet qe ata kane. Per nje pjese te konsiderueshme te banoreve, nje nder problemet kane qene dhe zhurmat e shumta ne Tirane edhe gjate nates, te cilat shkaktohen nga zhurmat e lokaleve. Rama e ka cilesuar kete gje si nje epidemi te lokaleve te nates qe po luan mendsh qytetaret, te cileve u duhet te flene gjume duke kercyer. Rama ka siguruar banoret se do te nderhyne ne lidhje me kete ceshtje, duke i propozuar Keshillit Bashkiak te Tiranes nje vendim per mbylljen e te gjitha lokaleve te

nates qe nuk plotesojne kushtet dhe prishin qetesin e qytetareve.

Fushata

Lokalet e nates te cilat shkaktojne zhurme dhe shqetesojne qytetaret, do te ndeshkohen me gjoba deri ne mbyllje te aktivitetit. Kete gje e ka deklaruar nje dite me pare drejtori i kabinetit te kryetarit te Bashkise se Tiranes, Eduart Shalsi. Ku sipas tij, Bashkia do te ndermarre nje fushate per penalizmin e te gjitha lokaleve te nates, qe me zhurmen apo muziken e tyre prishin qetesine e qytetareve. Nder te tjera Shalsi u shpreh: “Nisur nga shqetesimet alarmante qe banore te qytetit te Tiranes ne menyre te vazhdueshme kane adresuar prane Bashkise ne lidhje me zhurmat dhe muziken e larte qe lokalet, kryesisht ato te nates, shkaktojne ne pjese te ndryshme te kryeqytetit. U drejtohem i te gjitha subjekteve/lokaleve qe zhvillojne aktivitetet e tyre me muzike te larte, duke prishur qetesine publike dhe duke krijuar shqetesim te madh tek qytetaret. Keshtu, nese nuk respektohen rregullat, do te gjobiten”. Me tej Shalsi ka vijuar se: “duke u mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi, Bashkia e Tiranes informon dhe paralajmeron se do te ndermarre nje fushate kunder aktiviteteve te tilla, duke i penalizuar nga gjoba qe shkojne deri ne 100.000 leke te reja deri ne mbylljen e aktivitetit”. Ne perfundim ai ka kerkuar qe qytetaret te denoncojne aktivitete te tilla, si dhe lokalet te marrin masa per te siguruar qe veprimtaria e tyre te mos bjere ndesh me qetesine publike. Te dhena nga Ministria e Mjedisit sqarojne se norma e lejuar e ndotjes akustike eshte 50 decibel, ndersa ne kryeqytet ka zona ku niveli i ndotjes arrin gati dyfishin e normes se lejuar, deri ne 100 decibel.

Shkoder, rinis djegia e plehrave te “Varrezat e Deshmoreve”
Gazeta Koha Jone, fq. 14

Rifillon djegia e plehrave ne “Varrezat e Deshmoreve” te Shkodres. Duhet kerkuar “borxh” ndonje vend tjetër depozitimi i plehrave te qytetit. Mbas perfundimit te nje kontrate me komunen e Gurit te Zi, ku ajo lejonte qe plehrat e qytetit 140 mije banoresh te digjeshin ne buze te rruges per ne fshatin Rrenc dhe vetem 4 km larg Shkodres, ka filluar dje serish djegia e tyre dhe depozitimi ne “Varrezat e Deshmoreve” te rrethit. Ne to, varrezat nuk jane vetem deshmore te luftes antifashiste, por edhe patriote te Shkodres dhe veriut te Shqiperise. Ne fakt, te gjitha projektet e Bashkise se Shkodres deri tani nuk kane filluar dhe projekti i madh i ndertimit te nje land-field-i per perpunimin e mbeturinave dhe depozitimit te tyre diku ne zonen e Bushatit, do ende kohe per te filluar. Fushe tjetër bashkia nuk ka, dhe keshtu per disa vite plehrat e saj do t’i depozitoje dhe djege pikerisht te “Varrezat e Deshmoreve”. Vec mungeses se respektit per deshmoret dhe nje peisazhi krejtesisht anormal per cfaredolloj syri, ka dhe dy problemwe te tjera. Si fillim, zona tashme eshte e banuar dhe dendesia shtohet perdite. Tymi qe vazhdon pergjate gjithe kohes qe digjet shkon direkt te banoret e zonave te Bardhajve, atyre te stacioni i trenit, te lagjes “Mark lula” dhe deri ne fshatin Kuc, kur era eshte me e forte. Por akoma me keq edhe me depozitim ne ate vend, sepse lumi Kir tani ne vjeshte dhe ne dimer eshte me uje dhe ai merr te gjitha mbeturinat dhe i depoziton nga ana e tij ne Drin, pastaj Bune dhe direkt ne delten e saj ne detin Adriatik, prane Velipojes. Keshtu, Bashkia e Shkodres eshte kthyer dhe njehere ne kohen e tymit afer qytetit dhe ne lagjet periferike te saj dhe ne turpin e djegies se plehrave ne “Varrezat e Deshmoreve”.

BERAT, Zjarri shkrumbon kodren me ullinj
E.H, gazeta Koha Jone, fq. 12

Renia e nje zjarri ka shkrumbuar qindra rrenje me ullinj ne fshatin Fushe-Peshtan te Beratit. Burime te sektorit te zjarrfikeses ne kete qytet bene me dije se, pasditen e djeshme kane marre informacionin

per nje zjarr te rene ne kodren me ullinj. Por, ne momentin qe makinat kane mberritur ne vendngjarje, nje pjese e kodres ishte shkrumbuar. Siperfaqja e demtuar mesohet se shkon ne kater hektare me shkurre dhe rreth 200 dru ulliri. Pas nje ore perpjekjesh me flaket eshte bere e mundur te lokalizohet vatra dhe te shmanget djegia e pjeses tjeter te kodres. Vetem pak dite me pare, kodra mbi lagjen "Gorice", ne qytetin e Beratit, u perfshi nga flaket, ku u dogjen dhjetera drure pishe.

Drejtoria e rrugeve, masa permytjet nga lumi Drino
Gazeta Ballkan, fq. 8

Drejtoria Rajonale e Rrugeve ne Gjirokaster ka nisur rehabilitimin e gjithe segmenteve te brendshme rrugore qe lidhin qytetin e gurte me rrugen kombetare Tepelene-Kakavije. Paguesor Aliko, drejtori rajonal i rrugeve tha se "investimet synojne parandalimin e permytjeve nga vershimi i lumit Drino ne rrugen kombetare qe kalon ne qytetin e Gjirokastrës". "Gjate sezonit veror ky aks rrugor ka perballuar me sukses trafikun e renduar. Tashme jemi te vetedijshem qe asfalti i ketij segmenti rrugor eshte demtuar dhe per te perballuar stinen e dimrit po merren masat per te permiresuar infrastrukturen rrugore" tha Aliko. Sipas tij, fale nje fondi te siguruar nga qeveria shqiptare po rehabilitohet aksii rrugor ne hyrje te qytetit te Gjirokastrës (nga pika turistike e Viroit deri ne unazen e lagjes "Punetori"), me nje fond prej 1.3 milione euro akorduar nga qeveria shqiptare.

NGA BOTA

UASHINGTON, SAMIT NDERKOMBETAR PER NDRYSHIMET E KLIMES
Top Channel

Delegate nga 16 vendet me mjedisin me te ndotur ne bote do te takohen ne Uashington per te diskutuar mbi menytrat per te parandaluar ndryshimet e klimes. Takimi eshte organizuar nga presidenti Bush, i cili ka deklaruar se po kerkon veprime konkrete te lidereve te botes kunder ketij fenomeni. Perfaqesuesit do te hartojne masa per te ndaluar efektet e gazit serre dhe do te perpiqen te arrijne marreveshje per objektiva afatgata. Nderkohe, kritiket jane te shqetesuar se takimi mund te perdoret per te shtyre me teper vullnetaret te merren me kete ceshtje se sa per te arritur marreveshje. Shume shkencetare deklarojne se politika po deshton per te parandaluar kete fenomen, qe eshte me i rrezikshmi per Token.

OBJEKTIVAT E GJERMANISE PER DIOKSIDIN E KARBONIT "KUSHTOJNE SHUME"
ENDS Europe DAILY 2395

Shoqata e industrive gjermane ka botuar se fundmi nje studim i cili thekson se strategjia e qeverise per klimen eshte ekonomikisht e mundshme, vetem nese perfshin periudhen e nxjerrjes jashte perdorimit te reaktoreve nukelare.

Gjate kesaj faze, 17 reaktoret nukleare te Gjermanise duhet te nxirren jashte perdorimit brenda vitit 2012-te. Ne gusht qeveria gjermane hartoi nje sere masash qe synojne arritjen e objektivave te saj ne reduktimin e shkarkimeve te gazrave sere me 40% kundrejt niveleve te vitit 1999, kjo deri ne 2020-en. Studimi thekson se arritja e objektivit prej 40% do te vendose kosto te pamenaxhueshme mbi industrine dhe do te reduktojte rritjen ekonomike. Sipas studimit, te pakten 31% e reduktimeve ne shkarkime eshte e mundshme brenda 2020-es, dhe ketu perfshihet dhe energjia nukleare. Pa

energjiine nukleare, kostot ekonomike mund te arrijne midis 32 dhe 175 euro per ton dioksid karboni, vlereson studimi.

Me e pershtatshme, thekson studimi, do te jete nje reduktim i shkarkimeve me 26% deri ne 2020-en. Kjo do te arrihet me nje kosto prej 20 euro per ton dioksid karboni, pak a shume ne perputhje me cmimin aktual te lejeve per fazen e dyte te skemes se Bashkimit Evropian per tregtimin e shkarkimeve. Ministria e Mjedisit shprehet se nuk eshte dakort me perfundimet, por e mirepret studimin si nje baze e nevojshme per bashkepunim te metejshem midis industrise dhe hartuesve te politikave.

Per me shume informacion:

http://www.bdi-online.de:80/Dokumente/Umweltpolitik/PM_101-07_BDI_McKinsey_Klimagutachten_BDI.doc

BASHKIMI EVROPIAN AUTORIZON MISRIN E MODIFIKUAR GJENETIKISHT
ENDS Europe DAILY 2395

Komisioni Evropian do te autorizojte tre varietete te misrit te modifikuar gjenetikiisht per import ne Bashkimin Evropian, si ushqim per kafshet, pasi ministrat e bujqesise nuk morren dot nje vendim te perbashket ne kete ceshtje.

Zedhenesi i komisionit, Philip Tod, u shpreh se komisioni do t'i jape driten jeshile prodhimeve te modifikuara gjenetikiisht, ku secili lloj ka marre vleresime pozitive te sigurise nga ana e autoriteteve te Bashkimit Evropian per ushqim te sigurt.

Per me shume informacion:

http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/agricult/96072.pdf

Njoftime

11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: www.iwa2008budapest.org

Water is a challenge for the century.

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

Topics of the Conference:

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply

Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;
- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open (www.iwa2008budapest.org) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

The abstract submission period is open until the end of September 2007.

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditore do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: info@albania.REC.org

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>

www.mjedisot.info

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimprures qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht

ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek info@albania.rec.org
